



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 15 dhjetor 2011, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Mufera Şinik, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Ardian Gjini, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Amir Ahmeti dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Artan Canhasi – EULEX, Florie Mehmeti – KDI, Natyra Kasumaj – KDI, Rinor Beka – NDI, Reshit Gashi – NDI, Edon Myftari - këshilltar Ligjor – NDI, Lumnije Murati ZPRK dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 29.11 dhe 6.12. 2011,
3. Shqyrtimi i Projektregullores së Kuvendit,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që të shqyrtohet edhe Projektligji për Policinë.

Behar Selimi propozoi që si pikë e rendit të ditës të radhitet edhe Projektligji për Transmetimin Publik në Kosovë, i cili u përkrah edhe nga Arsim Bajrami.

Propozimi i deputetëve që kishte të bënte me Projektligjin për Transmetimin Publik në Kosovë u hodh në votim dhe me 5 vota “ për “ dhe 4 vota “kundër” u radhit si pikë shtesë e rendit të ditës.

Rendi ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 29.11 dhe 6.12. 2011

***Kryetari** konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 29.11 dhe 6.12. 2011, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i Projektregullores së Kuvendit

Kryetari ftoi z. Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit, të arsyetojë punën rreth versionit të parë të projektregullores.

Armend Zemaj- Theksoi se Nënkomisioni e ka përfunduar punën e vet dhe ka votuar në mënyrë unanime që ta sjellë në Komision për të ecur ma tutje. Përkundër angazhimit të kolegëve, edhe në komisionet e tjera, kanë marrë pjesë në hartimin e rregullores së re të punës së Kuvendit. Kjo është një rregullore e re, nuk është një plotësim ndryshim dhe një ndihmë të konsiderueshme e kanë dhënë edhe OSBE-ja përmes work – shopeve. Ai falënderoi të gjithë ekspertet që kanë dhënë kontribut në hartim të rregullores, e cila është e strukturuar mirë edhe në aspektin teknik edhe logjik. Gjuha juridike është profesionale, më lejoni të them që kemi norma të reja duke filluar nga harmonizimi me kushtetutën qartësinë e rolit të nënkryetarit të Kuvendit në harmoni me kushtetutën, Kryesinë e Kuvendit në format të ri, barazinë gjinore, shqyrtimin e projektligjeve në procedure të përsheptuar dhe sidomos çështjet që bëhen në integrimet evropiane. Vlerësoi se i plotëson edhe kushtet edhe standardet që ne kemi synim në integrim në Bashkimin Evropian, ka edhe shumë gjëra të tjera, sidomos te puna në Kuvend. Mendoj se i kemi shkurtuar edhe disa afate që e bëjnë punën më praktike dhe Kuvendin e vejnë në funksion të ligjbërjes, mbikëqyrjes dhe raporteve në mes organeve të tjera. Po ashtu, risia tjetër është që Kuvendit jo që i ka munguar transparenca publike, por atë e kemi avancuar edhe më shumë, në këtë drejtim duke filluar edhe nga organet e larta që të kemi transparencë publike në raport me qytetaret e Republikës së Kosovës.

Kryetari paraqiti vërejtje në nenin I , pika e dytë që krijon mundësinë për abuzim, e që thotë “ Çështjet që janë të lidhura me Kuvendin, që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore mund të rregullohen edhe me akte të tjera të Kuvendit në përputhje me kushtetutën “, vlerësoi që kjo duhet të hiqet, si dhe te neni 2, pika 2 që thotë “ Në rast se presidenti i republikës nuk e thërret séancë konstituive Kuvendi mblidhet vetë “, kjo nuk është e qartë se qysh mblidhet Kuvendi, sa vota duhen?

Për këtë diskutuan edhe Arsim Bajrami, Behar Selimi, Ardian Gjini, Albulena Haxhiu, Halit Krasniqi dhe Haki Demolli.

Edhe pse në mbledhje ishin të gjithë deputetet, në momentin e votimit të kësaj pike prezent ishin 8 deputetë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 7 vota “për” dhe “1” votë kundër u pajtua që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Deputetja Jasmina Zhivković hyri në mbledhje në orën 11:00 dhe nuk mori pjesë në votimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Deputeti Ardian Gjini u largua nga mbledhja pas përfundimit të pikës së tretë.

4. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Policinë

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Policinë, ku vërejtje paraqiti deputetja **Jasmina Zhivković**, e cila në diskutimin e saj pati vërejtje rreth amendamenteve të cilat kanë të bëjnë me përzgjedhjen e komandantit të stacionit policor, sidomos në komunat me shumicë të nacionalitetit serb. Ishte e mendimit se zgjedhja e komandantit të policisë në stacionet policore me shumicë serbe, sipas këtyre amendamenteve ka dalë jashtë Pakos së Ahtisarit. Mendimi i saj ishte se komandanti i stacionit policor në këto raste do të duhej të zgjidhej nga komuna. Nëse përzgjedhja e komandantit të stacionit policor dështon për të tretën herë atëherë komandantin e stacionit policor e zgjedh Drejtori i policisë ose Ministria.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 6 vota “për” 1 votë “kundër” dhe 2 “abstenime” nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-76 për Policinë, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

b. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Transmetimin Publik në Kosovë

Komisioni e shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Transmetimin Publik në Kosovë dhe për procedimin e mëtutjeshëm pati mendime të ndara të anëtarëve

të Komisionit. Raporti u hodh në votim dhe rezultati i votimit ishte 5 vota “ për “ dhe 5 vota “ kundër “, gjë që Komisioni nuk mori vendim për procedim të mëtutjeshëm të Projektligjit me amendamente.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi